



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6179 Prot.

Roskovec, më 17.07 2025

VENDIM

NR 35 .DATË 16.07 .2025

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN QERSHOR 2025”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 30.06.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Qershor 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5700/1 Prot.

Roskovec, më 01.07.2025

Procesverbal Nr.6

-I mbajtur sot, datë 30.06.2025, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Maj 2025.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2025.
5. Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Roskovec.
6. Për miratimin e planit vendor për barazinë gjinore 2025-2030.
7. Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" të Bashkisë Roskovec.
8. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.77 datë 23.12.2024 "Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025" të ndryshuar.
9. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
10. Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2026-2028.
11. Raport i monitorimit për 4-mujorin e I viti 2025.
12. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13²⁵

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toka, A.Hoxha, A.Pelo, S.Bibo Qamili.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, Rr.Hazizi, Zh.Metushi, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, P.Toro, V.Çepele, F.Feleqi.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomik S.Çepele, Dr.Juridik V.Zeqo, P/Shërbimit Social S.Saliaj, Dr.Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë E.Kuqo, Sp/zbatimit të Projekteve E.Zeka.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 12 këshilltar. Kryetari –mirdita të nderuar këshilltar ,të nderuar specialistë, i nderuar z.Nënkryetar i bashkisë. Faleminderit që jeni bërë pjesë e kësaj mbledhje të Këshillit të Bashkisë Roskovec, mbledhje e cila është njoftuar në datën 24.06.2025, me orar fillimi orën 13⁰⁰ .Po përfitoj nga rasti këtu që të tërheq vëmendjen për të gjithë këshilltarët, të cilët nuk tregohen korrekt sa i takon njoftimit të marr dhe nuk paraqiten në vendmbledhje në orën e caktuar, për më shumë pjesa e atyre që nuk janë bërë pjesë e kësaj mbledhje dhe nuk kanë një arsye të fortë për mospjesmarrjen. I lutem Sekretares që të evidentojë të gjithë këshilltarët të cilët nuk kanë marr pjesë në këtë mbledhje, për të vazhduar procedurat në bazë të objektivit që na jep rregullorja e bashkisë Roskovec. Duke vënë re se kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e kësaj mbledhje, pra në sallë janë 12 nga 21 këshilltarët e Bashkisë Roskovec, unë deklaroj këtë mbledhje të Këshillit të Bashkisë Roskovec të hapur.

1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari-pasi jeni njohur me rendin e ditës i shpërndarë tek ju datë 24.06.2025, ju njoftoj se nuk kemi asnjë ndryshim nga rendi i ditës me të cilin jeni njohur. Në qoftë se dikush nga ju nuk kërkon fjalën apo nuk ka diskutim, unë hedh në votim rendin e ditës të njoftuar paraprakisht tek ju. Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Maj 2025.

Sekretarja sqaron informacionin në lidhje me vendimet e miratuara muajin e kaluar. Në këtë mbledhje nuk kishim asnjë vendim me karakter normativ, të cilin duhej ta dërgonim në Prefekturë për konfirmim ligjor. Të gjitha vendimet janë zbardhur dhe pas hyrjes në fuqi u janë shpërndarë zyrave për zbatim.

3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- jeni njohur me procesverbalin e mbajtur në mbledhjen e datës 28.05.2025. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

4.Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2025.

Kryetari-ndërkohë që specialistja vjen në këtë sallë, paraprakisht do të pyesja këshilltarët nëse ka nevojë për një raport të detajuar në lidhje me këtë projekt-vendim? Elmazi-nëse nuk ka ndryshime në vendimin e qeverisë, ne nuk kemi çka të diskutojmë. Kryetari-pra ka apo nuk ka nevojë për relacion? Elmazi-nuk ka nevojë. Amarildo-plotësisht dakort që ta kalojmë. Kryetari-atëherë për sa kohë pyetje dhe diskutime nuk kemi për këtë projekt-vendim, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 12 vota pro.

5.Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve për Bashkinë Roskovec.

Dr.Enerida Kuqo-të nderuar anëtar të Këshillit të Bashkisë, Bashkia Roskovec ka hartuar planin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, me mbështetje teknike dhe financiare të qeverisë gjermane dhe projektit GIZ, në kuadër të fazës së dytë të projektit modernizim, menaxhim të mbetjeve të ngurta në mënyrë të përshtatshme me klimën dhe riciklimin. Deri më sot Bashkia Roskovec nuk e ka pasur këtë plan dhe si një detyrim ligjor ka lindur nevoja për hartimin e tij. Me një urdhër të brendshëm është ngritur grupi i punës, i cili ka punuar në bashkëpunim me ekspertë të caktuar nga GIZ, të cilin e kemi dhe të pranishëm sot z.Ervin Doçaj. Plani është hartuar me pjesmarrjen aktive të stafit teknik të bashkisë dhe me asistencë nga partner ndërkombëtar, ai parashikon skenar të ndryshëm për organizimin dhe financimin e shërbimit si një plan veprimi konkret për periudhën afatmesme. Është hartuar gjithashtu dhe VSM-ja në bazë të ligjit 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor” si një dokument i rëndësishëm i planit. Në muajin Maj 2025 ka përfunduar drafti, VSM-ja i cili më pas ka kaluar në fazën e konsultimit publik, bazuar në ligjin përkatës. Konkretisht drafti është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë duke respektuar afatin ligjor 20 ditë dhe më pas është zhvilluar në datën 02.06.2025, me pjesmarrjen e Ekzekutivit të bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përfaqësues të Agjencisë Kombetare të Ekonomisë së Mbetjeve, përfaqësues të Bankers Petroleum, Eko desk, Kryetar fshatrash, Administrator të Njësive, qytetarë, etj. Elmazi-ne materjalin e kemi parë, e kemi lexuar dhe nuk kemi ndonjë vërejtje. Kryetari-sidoqoftë një relativitet i shkurtër ishte, në qoftë se të nderuar këshilltar nuk kanë dëshirë ta dëgjojnë relacionin sepse e kanë parë paraprakisht, e ezaurojmë këtë pjesë të relativitetit. Për sa kohë jeni njohur me materjalin, e kërkon dikush fjalën për ndonjë pyetje, për sa kohë kemi pëspecialisten? Njëkohësisht kemi dhe specialistin z.Ervin Doçaj, në qoftë se edhe për të dikush nga këshilltarët do të kishte ndonjë pyetje me interes të veçantë? Nuk ka pyetje. Kryetari-atëherë fjalën për diskutime kush e kërkon? Nuk ka diskutime. Kryetari-të nderuar këshilltar për sa kohë për këtë projekt-vendim nuk kemi pyetje dhe diskutime, ju ftoj të votoni projekt-vendimin. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 10 vota pro, 2 vota abstenim A.Hoxha, A.Pelo. Me 10 vota pro miratohet ky projekt-vendim.

6.Për miratimin e planit vendor për barazinë gjinore 2025-2030.

Kryetari-nisur nga qëndrimi i mbajtur në projekt-vendimin pararendës, do doja tju pyes është nevoja që të kemi një relacion të shkurtuar nga specialistja apo kalojmë në pyetje dhe diskutime për këtë projekt-vendim? Lexi-është e njëjta gjë. Elmazi-e njëjta gjë është, ne e kemi parë. Lexi-dhe dëgjesa publike është bërë, nëse do kemi diçka do flasim. Kryetari-atëherë ka dikush nga këshilltarët ndonjë pyetje rreth këtij projekt-vendimi? Për diskutim kush e kërkon fjalën? Atëherë pyetje dhe diskutime nuk kemi, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

7.Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” të Bashkisë Roskovec.

Kryetari-do ta dëgjojmë relacionin e përmbledhur për këtë pikë apo do mjaftoheni me relacionin e shpërndarë bashkë me materialet? Elmazi-nuk kemi ndonjë gjë për të shtuar ose për të hequr nga ata të cilët ne kemi këtu, prandaj unë mendoj që ta kalojmë. Kryetari-atëherë për sa kohë mendoni që relacioni është i qartë për pjesën e shpërndarë tek ju nëpërmjet informacioneve dhe materjaleve që ju kemi dhënë, kalojmë në seancën e pyetjeve, kush ka pyetje? Amarildo- në lidhje me personat që janë nuk kemi asnjë kundërshtim, kanë pjesën dhe kontributet e tyre në jetën dhe aktivitetet e bashkisë dhe zonës së gjithë Roskovecit, por kisha dy pyetje në lidhje me propozimet dhe miratimet. Konsultimet dhe propozimet nuk kanë ardhur nga të gjithë banorët apo përfaqësuesit e tyre sepse ka akoma sot që flasim, ka njerëz që na kanë dhënë emra të tjerë dhe nuk janë pyetur, nuk është marr mendimi i tyre pavarësisht se do e meritonin apo jo titullin “Qytetar Nderi”, këtë do e vendoste komisioni. Do kisha dëshirë që herë tjetër minimumi konsultimi të jetë më i hapur dhe të bëhet në mënyrë transparente, që të mos kemi as përplasje, as qejfmbetje dhe pastaj kush e meriton le ta gëzojë. Unë kisha një propozim meqënëse jemi këtu në rastin konkret. Bëhet fjalë për një propozim nga komuniteti, nga fshati Vidhisht, do ju lutesha ta mbani shënim. Bëhet fjalë për Rushit Çausht Hoxha, ka qënë pjestar i forcave Nacionalçlirimtare, ka dhënë kontributin e tij në çlirimin e vendit, pas lufte ka pasur kontribut duke kontribuar si oficer karriere në ushtrinë shqiptare për një periudhë të gjatë kohore, dhe në fund ka dhënë kontributin e tij kur është kthyer në vendlindje në Roskovec. Kisha dhe diçka në lidhje me biografitë, shoh një prej biografive këtu që nuk është nevoja ti përmend emrin zotrisë, nuk e di kush i ka shkruar, relatuar këto por po citoj : shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ku u dallua e tjerë, e tjerë, megjithatë thotë varfëria, shtypja e bejlerëve dhe agallarëve si dhe pushtimi fashist e tjerë, e tjerë, bëri që të merrte rrugën e luftës. Do ju lutesha shumë këto epitetet ballist, fashist, kulak të mos vazhdonin më pas, të paktën pas 90-tës e këtë, nuk do ishte mirë. Nuk po i hyj kush i ka shkruar por minimumi duhet ti shikoni këto. Tani e dimë të gjithë luftën e klasave që ka ndodhur, mbase dhe dikush nuk e kupton dot se çdo të thotë fjala bejler, mbase se di nuk ka ndonjë gjë të keqe, mund të marri informacion por të dijë që ata që kanë krijuar këtë shtet, pavarësinë e tyre, babai i këtij shteti ka qene Ismail bej Qemal Vlora e të tjerë me radhë, pas tyre Iljaz bej Vreoni, edhe Isa bej Boletini. Këta kanë qënë ata që kanë formuar këtë shtet që gëzojmë ne sot, ndaj do ju lutesha shumë kjo të hiqet nga ky tekst sepse ofendon të gjithë ata që me mund e djersë kanë arritur, kanë dhënë kapital, kanë dhënë prona dhe në fund janë marr në mënyrë të padrejtë dhe sot e kësaj dite që flasim ndoshta nuk i gëzojnë. Maksi-sa i përketë propozimeve është një komision i ngritur me urdhër të Kryetares së bashkisë dhe kryesohet nga ana ime si Nënkryetar, njëkohësisht ka dhe dy figura Agron Gogën dhe Ramadan Hoxhën nga jashtë, dhe dy punonjës të administratës, një punonjës i Kulturës dhe një punonjës i Drejtorisë Juridike. Propozimet normalisht nuk është një proces që u mbyll sot apo u mor një vendim për këta të pestë, ne mendojmë që në çdo festë qoftë tek ajo e 24 Korrikut apo dhe në fund të vitit, vazhdimisht kemi marr propozime nga shoqatat, qoftë edhe nga individit ose dhe nga Kryetarët e fshatrave që përfaqësojnë fshatin. Jemi të hapur për propozime të tjera, dhe propozimi juaj ka vend, jo vetëm propozimi juaj por çdo propozim tjetër nga çdo anëtar Këshilli. Ka dhe eksperiencia që dhe nga anëtarët e Këshillit kanë dhënë propozime, i ka marr parasysh komisioni dhe ne pasi miratojmë në komision një numër të caktuar, për mos ta bërë këtë numër sa më të madh të titujve të nderit për arsye se titujt i jep Këshilli i bashkisë, por titull mirënjohje jep dhe Kryetarja e bashkisë me autoritetin që ka në bazë të ligjit. Për qytetarët e nderit kemi menduar të ketë një numër sa më të kufizuar dhe mundësisht të mos jenë në këtë jetë por të kenë mbyllur ciklin e jetës, me qëllim që të mos përflitet nesër, pasnesër. Kjo ka qënë një nga objektivat tona, i

kemi marr parasysh për këtë, dhe atë do ta shikojmë por pasi ne i miratojmë kalojnë në Institutin e Pastërtisë së Figurave në Tiranë, dhe pasi marrim miratimin që andej që nuk kanë qënë bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit, ne e kalojmë në Këshillin e bashkisë. Sot propozimit për të ndierin Rushit është për diskutim në komision dhe deri në fund të vitit besojmë se do miratojmë prapë, ta kemi nga prioritetet tona dhe për këdo tjetër jemi të hapur. Ndërsa sa i përket konsultimit unë e thashë, pastaj ky është në CV nuk është në motivacionin e qytetarit të nderit, por ka vend për korrigjim jam plotësisht dakort, por nuk është në motivacion. Leksi-sdua ti rikthehem edhe një herë diskutimit të vjetshëm, kam folur për pjesën e qytetarëve të nderit që shpall Këshilli bashkiak. Besoj se me këta pesë nuk e diskutojë që jam dakort, normalisht sepse i ka kaluar të gjitha konsultimet dhe propozimet që janë bërë, por biografia e tyre duhet të jetë çik dhe më e pasur, se mua më ngjan shumë e ngurtë. Që të shpallet qytetar nderi në bashkinë e Roskovecit duhet që të ketë lënë emër tamam, nuk po them për këta dhe për ata që kemi kaluar. Kemi dëgjuar dhe tjetër herë që duhet të jenë patjetër të larguar nga jeta, se ne kemi dhënë dhe qytetar nderi që janë akoma gjallë..Maksi-thashë prioritet, pjesa më e madhe janë larguar nga jeta. Leksi-unë kam dhënë një propozim më përpara, se kontribute të jashtëzakonshme këtu në komunitet kanë dhe mësuesët. Mësuesët kanë një kontribut të jashtëzakonshëm dhe me detyrën e tyre fisnike që kanë, që edukojnë breza të tërë dhe është për tu habitur sa herë kalojmë dhe në Korrik dhe në fund të vitit, ne nuk kemi një mësues që ta kalojmë dhe ta propozojmë për ta bërë qytetar nderi. E meritojnë se kanë edukuar shumë breza dhe vazhdojnë të edukojnë, vazhdojnë të lodhen për të rritur breza të tërë, një armatë të tërë njerzish që ti shërbejnë këtij vendi. Ndoshta mund të avanconim që ti bënim një propozim këtij komisioni por besoj se mund ta konsideroni por si gjithmonë kur se konsideroni vazhdoni ti bëni vet gjërat, dhe kjo më vret çik thotë me propozim të Kryetares së bashkisë, besoj mund të jetë propozim i komisionit që ti sjelli në Këshillin e bashkisë apo e ka si ligj ky propozim? Se kur thotë propozim direkt i Kryetares së bashkisë ngjan sikur i propozon vetëm ajo, këtu kështu thotë me propozim të Kryetares së bashkisë, Kryetarja e bashkisë ka paraqitur propozim për dhënien e titullit qytetar nderi. Maksi-po, në bazë të komisionit. Leksi-po ngjan çik keq tani, sikur i ka propozuar kjo. Maksi-thashë edhe njëherë, shoqata dhe individë të caktuar. Leksi-atëherë do thoje shoqata i ka propozuar po jo Kryetarja e bashkisë, se kështu e ka materjali. Maksi-po, se komisioni ia paraqet Kryetares, Kryetarja ia paraqet Këshillit, nuk ka të drejtë komisioni ti paraqesi Këshillit ekzekutimin e këtij vendimi të komisionit. Leksi-ore më ngjan sikur e ka marr inisiativën Kryetarja e bashkisë. Dr.Juridike Vjollca-Leksi në bazë të ligjit për titujt vendor të nderit, propozimin e sjellë Kryetarja e bashkisë ose një nga përfaqësuesit e Këshillit vet, ndaj dhe propozimi vjen nga Kryetari i bashkisë pasi janë marr propozimet..Leksi-për pjesën tjetër, të ketë sa më shumë mësues, personalitete të shquara në komunitet. Elmazi-duke parë të gjithë këta që ka paraqitur grupi i punës pranë Kryetares së bashkisë dhe nga shoqatat, unë them se për të gjithë këta nuk shoh asnjë gjë që ne të ngrejmë ndonjë vërejtje apo problem, janë njerëz që e meritojnë. Duke qëndruar pak tek të dhënat, biografia që shkruhet në CV, unë mendoj se secili nga ne kushdo qoftë ai, ajo është puna duhet thënë ashtu si ka qënë. Po mo do thotë në letër që Elmaz Çepele ka qënë me Ballin, kam qënë ballist unë, ballist kam qënë tha ai po ta keni ndjekur me kujdes, por kur vjen puna për të marr një titull shkencor apo andej-këtej, unë jam 100% me ata që e meritojnë për të qënë figura. Po ne po vëmë figura sot nga ata që nuk ruajnë më lopë për mendmin tim dhe po i vëmë atje ku nuk duhen vënë, po jo për në atë kohë që ishin me arsim fillorë, 8-vjeçare, të mesme dhe rrokën pushkët dolën në mal, se ishin për një qëllim. Ata ishin për të luftuar, për të çliruar Shqipërinë dhe ata ishin për të bashkëpunuar ose për të ndenjur në dy pozicionet e tyre, që ishte ajo

luftë dhe atë luftë se mohon dot njeri. Ne duhet të themi të vërteta pa bejlerë dhe agallarë, ka bejlerë më shumë sot sesa dje, ata dje e dinë vet ata të zezë se ç'a kanë hequr ata që kanë qënë, sot e dinë ata dhe e di SPAKUI më shumë sesa ne, prandaj nuk i hyjmë këtyre punëve ne, ne i hyjmë punës së realitetit, a duhet të jenë këta persona që janë këtu apo jo? Për mua duhet të jenë, a ka të tjerë që nuk janë? Ka, ka plot dhe mua më vjen keq ndaç nga Vidhishta, ndaç nga Kumani, ndaç nga Luari, ndaç në Ngjeqar, ndaç në Mbërs, ndaç në Arapaj, ndaç në Suk 1, Suk 2, ka plot që nuk trajtohen dhe që duhen trajtuar sepse kanë meritat e punës së tyre, kanë punuar, i kanë dhënë këtij shteti dhe i japin kësaj shoqërie, prandaj unë gjykoj shoku Nënkrjetar që në të ardhmen duhet të shikoni më mirë këtë pozicion. Po ka mundësi nga ana juaj dhe e grupit të punës dhe shoqatat, që të përzgjidhen njerzit që duhet të jenë dhe mundësisht ti kenë dhënë shoqërisë në arsim dhe kulturë, bujqësi se ka plotë nga ata që kanë qënë agronom, kanë qënë mësues siç e tha dikush më përpara, po kanë qënë dhe inxhinier, kanë qënë dhe arkitekt, kanë qënë dhe farmacist, doktor. Këtyre u duhet dhënë që dhe ne të kemi ç'a vlersojmë këtu në bashkinë tonë. Maksi-proçesi është i hapur dhe jemi të hapur për çdo lloj propozimi. Kur proçesi kalon të paktën dy herë në vit në Këshillin e bashkisë, do të thotë që nuk jemi bërë ne pengesë ose barrier, që ne të themi tani që deri këtu jemi. Në çdo kohë proçesi është i hapur. Kryetari-faleminderit z.Maksi. Do doja tju falenderoja edhe njëherë të gjithëve ju këshilltar të pranishëm sepse në lartësinë e besimit që na ka dhënë komuniteti, jemi në këtë mbledhje këtu sot, por doja tju rikujtojë se ligji dhe rregullorja njeh propozimin e çdo këshilltari si njohës i mirë i komunitetit nga i cili vjen, për të bërë propozime pranë komisionit përkatës për këtë çështje, kështu që do ju lutesha secilit këshilltar i cili në komunitetin që ai përfaqëson, komuniteti i cili e mbështet, për të gjitha rastet që ka, personalitete të cilat duhen le të themi vlerësuar dhe duhen shpënë drejt këtij komisioni të ngritur nga ana e bashkisë, janë të lutur që të paraqiten me dokumentacionet përkatëse për të hapur një procedurë dhe për vlerësimin pse jo të të gjithë atyre kontributorëve për këtë komunitet. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin "Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" të Bashkisë Roskovec" z.Tofik Kasëm Kodheli, z.Naun Stefan Baba, z.Marko Uani Prençe, z.Alush Sali Metohu, z.Shahin Halit Satëri, dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro. Kryetari-me të gjitha votat pro miratohet ky projekt-vendim. Është vlerësimi minimal që mund ti bëjmë kontributorëve të vërtetë për komunitetin e bashkisë tonë. Ta gëzojnë këtë titull të gjithë ata për të cilët u akordua sot nga ky Këshill i nderuar.

8.Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.77 datë 23.12.2024 "Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025" të ndryshuar.

Kryetari-këtu kemi specialisten e cila do të bëj relatimin e këtij projekt-vendimi të rëndësishëm. Është gjithmonë në vullnetin tuaj nëse dëshironi që të dëgjoni relacionin apo jeni njohur paraprakisht dhe të kalojmë në pyetje dhe diskutime? Elmazi-kalojmë në pyetje dhe diskutime. Kryetari-atëherë në qoftë se jeni njohur paraprakisht, kalojmë tek pyetjet. Kush ka pyetje për ti bërë specialistes në lidhje me këtë projekt-vendim? Për diskutim e kërkon njeri fjalën? Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe me 10 vota pro, 2 vota abstenim A.Hoxha,A.Pelo nuk miratohet ky projekt-vendim. Kryetari-na duheshin minimalisht 11 vota.

9.Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2025.

Kryetari-këto dy projekt-vendime janë të pavarura nga njëra-tjetra? Selmani-jo nuk ka lidhje me atë që nuk u miratua, ishte vetëm ndryshimi i numrit të punonjësve. Kryetari-atëherë dëshironi ta dëgjoni relacionin në lidhje me këtë projekt-vendim? Selmani-këto ndryshime ua paraqesim pas një analize që kemi bërë në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 6-mujore 2025. Gjithashtu këto shpenzime që neve ju paraqesim shtesë janë brenda buxhetit të miratuar të vitit 2025, janë ndërmjetë programeve kështu që kërkon miratimin tuaj për këtë qëllim. U kemi paraqitur dhe shtesat dhe pakësimet sipas artikujve, gjithashtu dhe relacionet përkatëse për argumentimin e këtyre ndryshimeve. Gjithashtu këto ndryshime do të vijnë më tej me ndryshimet që do ti bëhet në PBA 2026-2028, pas miratimit tuaj. Kryetari-për pyetje kush e kërkon fjalën? Amarildo-në lidhje me relacionin nuk kemi asnjë pyetje por idea është këtu, që materialet gjithë kohës janë në dispozicion, shikojmë që kemi materjale hidraulike, elektrike, marangozi dhe ka mbi dy muaj mos më shumë në shkollën Vidhishtë është thyer një xham i derës kryesore dhe sot që flasim është akoma i thyer dhe rrezikohet baza materjale, dosjet e nxënësve, kompjuterat, dhe për pjesën e rojes e thashë dhe në formë shakaje qëparë, rojet duhet ta kryejnë funksionin se për atë paguhen. Po të vemë tani në shkollë bashkë, futemi kur të duam dhe dalim kur të duam. Janë bërë mësuesit si roje, i bie që po bëjnë dy punë, bëjnë dhe rolin e rojes dhe të mësuesit. Ka plot roje sot po ti marrim gjithë institucionet me radhë, që nuk shërbejnë, që nuk e kryejnë punën. Nuk jemi në kundërshtim ler të jenë në punë, të marrin dhe ata rrogën e tyre por të shikojnë dhe ata punën që marrin përsipër ta kryejnë. Se ti rri këtu punon 8 orë apo jo? Siç rri ti 8 orë të rrinë dhe ata zotrinjtë atje, të kryejnë detyrën përderisa e kanë marr përsipër. Në rast se kanë vajtur për të marr rrogën, tja lënë dikujt tjetër se ka dhe hallexhinj që duan ta marrin rrogën dhe ta bëjnë atë punë, mbase e bëjnë dhe më mirë se këta që janë. Nuk bëhet fjalë skemi asgjë thashë, çdo pozicion pune do ketë një punonjës por ta kryejnë detyrën, jo mos të përpiqet fare dhe janë bërë shkollat si han me katër porta. Mund të shkosh sot të hysh dhe të dalësh sa herë të duash, ska asnjë lloj kontrolli. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe me 10 vota pro, 2 vota abstenim A.Hoxha, A.Pelo nuk miratohet ky projekt-vendim.

10.Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2026-2028.

Selmani-është pjesë e punës 1-vjeçare e cila konkludohet mbi këto raporte dhe pastaj më tej në raportin përfundimtar për PBA 2026-2028, i cili do të përmbyllet dhe me miratimin e buxhetit të vitit 2026. Ky dokument që ne ju paraqesim është identik siç ia kemi përcjellë dhe Ministrisë së Financave brenda afatit dhe mbi bazën e këtij dokumenti do të vazhdohet më tej, me përcaktimin e tavaneve përfundimtare në mbledhjen vijuese në Korrik 2025. Natyrisht do pasqyrohen edhe ndryshimet që mund të pësojë buxheti gjatë kësaj periudhe, deri në fund të Korrikut 2025. Që të vazhdohet puna më tej kërkojë miratimin nga ana juaj të këtij dokumenti. Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

11.Raport i monitorimit për 4-mujorin e I viti 2025.

Kryetari-besoj jeni njohur me këtë raport. Ky është raporti monitorues për 4-mujorin e parë të vitit 2025. Në qoftë se dikush ka ndonjë pyetje në lidhje me këtë raport, po ju njoftoj paraprakisht që ky raport nuk ka nevojë për votim, thjeshtë këshilltarët njihen me këtë raport dhe në qoftë se kanë pyetje për të drejtuar, janë të lutur që të shfrytëzojnë që këtu kemi drejtorin e drejtorisë përkatëse. Nuk ka pyetje dhe diskutime për këtë raport.

12.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Amarildo-duke qënë se këtë kërkesë ja kam bërë këtu e para 3 muajve Maksit, meqënëse është prezent po ia bëj sërish. I kam kërkuar vendosjen e dy pengesave para shkollës Vidhisht. Unë nuk e di pse ka vonuar për të vendosur dy mbrojtëse, dy barriera penguese para një shkolle, që përbënë rrezik për fëmijët, kur ne kemi pasur raste në zonën tonë që kanë humbur jetën nga aksidentet. Edhe një kontroll, një monitorim duke bashkëpunuar dhe me Postën e Policisë sepse vërej gjithë kohën fëmijë jo nën 18 vjeç por dhe nën 15 vjeç që marrin mjetet e prindërve dhe që ata janë në një farë mënyre bashkëpunëtorë, që të ketë një kontroll të gjithë zonës dhe të bëjnë evidentimin e këtyre personave që bëjnë shkelje. Ndërsa për pjesën e kësaj mendoj se duhej ta kishe zgjidhur Maksi, se nuk ka nevojë për tender për të vendosur dy pengesa para një shkolle, që mund të përfundojë dhe besoj se do fillojë sërish në Shtator dhe nuk do i vendosim. Maksi-ne e kemi diskutuar, atje duhen polica të shtrirë por ne rrugë dytësore nuk ka nevojë për polica sipas kodit rrugor. Megjithatë ne meqë është shkollë do të bëjmë sinjalistikën e rregullt atje, pastaj do shikojmë..Amarildo-është shkollë Maksi, rruga është e ngushtë..Maksi-po jo polica të shtrirë por pengesa me rërë bituminoze. E kemi diskutuar dhe do ta shikojmë mundësinë për ta bërë. Amarildo-ajo nuk ka nevojë për të bërë tender. Maksi-ka nevojë se ka vlerë por para Shtatorit do mundohemi ta vendosim se e kemi diskutuar. Amarildo-një shqetësim tjetër që ka komuniteti është uji që shkon në familje, shkon ngjysmë ore në mëngjes, 40 minuta maksimumi. Mund ta verifikoni sepse unë e kam verifikuar, temperaturat janë 40 gradë siç po e shikoni, vera do jetë akoma më e nxehtë, do ju lutesha ta shikoni këtë problem. Minimumi duhet të shkojë 2 herë në ditë, nuk e kuptoj pse sot që flasim shkon gjysmë ore, nuk arrijnë dot qytetarët të mbushin depozitat. Është problem shqetësues, nuk e di nga kush e merr urdhërin, si veproni, ku e keni problemin? Maksi-se kemi ne si bashki por e ka ujësjellësi, do ti drejtohem me shkresë dhe ti kërkojmë menaxhimin sa më të mirë të ujit. Amarildo-këto dy kërkesa duhet të merren parasysht, jo se po ti them unë, i ke nga komuniteti sepse nuk i kërkojë për vete, i kërkojë për ata qytetarë që jetojnë atje përditë dhe është shumë shqetësuese. Besoj se janë të realizueshme dhe të zgjidhshme, kërkojë mirëkuptimin nga ana jote, nuk po të kërkojë diçka që nuk është e mundur, këto janë brenda mundësive, duke bashkëpunuar dhe duke menduar bashkarisht ti realizojmë, kaq kisha faleminderit. Elmazi-në mbledhjen e parë kemi ngritur disa probleme për të cilat është zëri i qytetarëve dhe jo i yni si individ. Kemi ngritur në radhë të parë për rrugën nga shtëpia e Kollit të Ndinës dhe deri poshtë, që është tërë gropa. U tha mendim se do bëhej ajo rrugë por nuk është bërë. Kërkojë nëpërmjet jush nëse është e mundur, rruga që kalon nga shtëpia e Kollit dhe del tek ura e parë e Matkës që nuk e di sesi është bërë ashtu, duhet të verifikohet se ç'a i takon bashkisë ta mirëmbajë, po ka mundësi ta mirëmbajë atë rrugë se ajo i vlen tërë fermerëve. Problemi i dytë që ngrenë fermerët është problemi i vaditjes, ka mundësi, si mundet që tu lëshohet uji, të paktën për atë prodhim që ata kanë mbjellë ta vadisin. E treta është për rrugët e blloqeve. Bëhet gjë për rrugët e blloqeve apo jo? Nuk e di, lekët taksapaguesit i paguajnë dhe nuk është hedhur asnjë gjë deri në këtë moment në rrugët tona,

që nga 8/1 deri tek 8/8 në kufi me Sukun, janë 8 blloqe rresht nuk shkon dot sepse janë bërë të vësh duart në kokë, të vesh ti me makinën tënde jo, dhe me zetar nuk hyn dot sepse dhe vet fermerët kanë bërë disa gabime sepse nuk ka kush kontrollon. Ça janë kanale vaditës për të marr ujë për ta hedhur në krahë tjetër dhe e ka bërë gropën 1 metër e gjysmë brenda në ujë. Këto duhet të verifikohen nga ata që e kanë për kompetencë prandaj ju lutem kush e ka të na ndihmojë për tokat bujqësore, se ne nëpërmjet tyre ushqehemi. Leksi-për problemin që e kam ngritur disa herë më përpara, për çështjen e hapjes vend e pa vend nëpër rrugët që janë investuar, për difektet e ujësjellësit dhe nuk arrijnë që ato gjëra të mbulohen se në gjendjen e mëparshme nuk kthehen më. Çdo rrugë e qytetit që është investuar, kemi vetëm eliminimin e difekteve të ujësjellësit dhe gropa që qëndrojnë akoma hapur dhe nuk kthehen akoma në gjendjen e mëparshme. Është gjynah sepse është investuar ai lekë nga taksapaguesit tanë, një. Te vendgrumbullimi i plehrave në Roskovec, ajo përbënë rrezik të jashtëzakonshëm, mbuluar me ferra, ndoshta në një të ardhme mund të shikohet një plan..Maksi-ajo ka vite që është mbuluar. Leksi-po nuk është e mbuluar se unë atje kaloj, ajo do mbuluar e gjitha sepse përbënë rrezik. Maksi-ajo do pastruar, do kthyer duke qënë se nuk është tokë shtet, do kthyer në pikë kompostimi, ta mbulosh me dhe. Leksi-po dakort, vetëm do parë sepse përbënë rrezik për zjarre tani, ajo është rrezik i madh dhe për ndotjen e ambjentit. Te një kanal që e përmbledh projekti Unaza Perëndimore, është një kanal i ujërave të zeza që përshkon të gjithë familjet që janë atje, mbi 10 familje. Gjatë bisedës që kemi bërë me Kryetaren, thotë është e përfshirë në projekt. Nuk mund ta marrim të ndarë atë, që të arrijmë të mbulohet ai kanal sepse nuk mund të qëndrojnë ato familjet atje nga era shumë e keqe që shpërndanë, sidomos tani në stinën e verës që ai nuk ka ujë, ai shpërndanë një erë shumë të keqe jo vetëm aty afër familjeve por edhe diku këtej në qytet. Është degë e Unazës Perëndimore nëse mund ta quajmë kështu, se Unaza Perëndimore ngeli si titull se për të investuar sdihet se kur investohet. Kemi hyrjen e qytetit mesa shikoj unë, parmakët e totuareve që fillon nga Zenel Plaka deri këtej që janë të shtrembëruar, të këputur, të palyer. 5 kova bojë mund të duhen atje dhe ti fusin një lyerje, një farë rregullimi, një farë estetike sepse përbënë hyrjen e qytetit aty, o të jenë o të mos jenë fare. Këto kisha unë, ishalla gjejnë zgjidhje. Nuk ka më probleme apo diskutime të ngritura nga këshilltarët. Kryetari-duke ju falenderuar edhe njëherë të nderuar këshilltar pjesëmarrës në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, duke ju kujtuar këshilltarëve që mungonin sot në këtë mbledhje, se bazuar në betimin e bërë në pranimin e këtij mandati me vullnetin e tyre të lirë, në respekt të besimit të marr nga qytetarët dhe në zbatim të rregullores së bashkisë, duhet të bëhen pjesë e mbledhjeve dhe aktiviteteve të Këshillit, duke u bërë në këtë formë vërtetë përfaqësues. Është mënyra për të përcjellë dhe për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e qytetarëve, të cilët ju kanë besuar. Unë e deklaroj këtë mbledhje të mbyllur, ju faleminderit edhe njëherë për pjesëmarrjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

